



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University	
Pranuar nga data:	13.08.2026
Vendi dhe numri:	05/1639

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

"Zija Shemsu" p.n., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

FORMULARI I VLERËSIMIT F2

Fakulteti	Fakulteti i Ekonomik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Institucionet Financiare Ndërkombëtare; E Drejta Biznesore Ndërkombëtare; Globalizimi dhe Tregtia Ndërkombëtare; Menaxhimi dhe E-Qeverisja; Statistika për E-Qeverisje.
Thirrja për të cilën konkurron kandidati	Profesor asocuar (Prof. Asoc. Dr)
Kandidatët e paraqitur:	1. Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani

Sqarim nga Komisioni vlerësues:

Komisioni vlerësues, në ushtrimin e mandatit të përcaktuar me aktet normative të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, është bazuar në konkursin publik nr. prot. 01/1446, datë 21.07.2026, të shpallur për avancim akademik në thirrjen Profesor i Asociuar Dr. (Prof. Assoc. Dr.) në Fakultetin Ekonomik, për fushat/lëndët e përcaktuara në pikën 3 të konkursit: Institucionet Financiare Ndërkombëtare; E Drejta Biznesore Ndërkombëtare; Globalizimi dhe Tregtia Ndërkombëtare; Menaxhimi dhe E-Qeverisja; Statistika për E-Qeverisje.

Brenda afatit të përcaktuar në konkurs dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurale në fuqi, Komisionit i është paraqitur një (1) aplikacion për këtë procedurë të avancimit akademik. Pas verifikimit formal të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni ka konstatuar se aplikacioni i kandidates i plotëson kushtet për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit profesional dhe akademik.

Komisioni ka shqyrtuar në mënyrë të gjithanshme dhe objektive të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatja Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani, duke vlerësuar përmbushjen e kriterëve akademike, shkencore dhe profesionale, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka", si dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, datë 26.06.2024.

Vlerësimi i kandidates është realizuar mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritokracisë akademike, duke marrë për bazë gradën shkencore, përvojën akademike, veprimtarinë kërkimore-shkencore, publikimet, kontributin në procesin mësimor dhe angazhimet e tjera relevante universitare. Rezultatet e këtij vlerësimi paraqiten në formularin vijues, i cili përbën pjesë përbërëse të raportit të Komisionit vlerësues.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Asoc. Dr. Fadil Osmani, kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Demir Limaj, anëtar
3. Prof. Dr/ Vehbi Ramaj, anëtar

TË DHËNAT-PËR KANDIDATIN

Kandidatja: Valbona Zeqiraj Nimani

Tabela 1. Të dhënat për kandidatin për të cilin shkruhet raporti

Emri dhe mbiemri		Valbona Zeqiraj Nimani
Ditëlindja dhe vendlindja		30.06.1983 Glllogjan Deçan
Grada shkencore dhe viti kur është fituar		Doktor e shkencave Ekonomike, 2018
Titulli akademik		Profesor saistent
Viti kur është fituar titulli akademik		2021
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar thirrja akademike		Fakulteti Juridik , UKZ
ARSIMI I LARTË¹		
STUDIMET THEMELORE	Institucioni	Universiteti i Prishtinës
	Vendi	Prishtinë
	Grada shkencore e fituar	Bachelor
	Data / viti i diplomimit	2008
	Fusha e studimit	Banka , Financa dhe Kontabilitet
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	Institucioni	Kolegji Globus
	Vendi	Prishtinë
	Grada shkencore e fituar	Master i shkencës
	Data / viti i diplomimit	2011
	Fusha e studimit	Banka financa dhe kontabilitet
STUDIMET DOKTORATËS	Institucioni	Universitet European i Tiranës
	Vendi	Tiranë, Republika e Shqipërisë
	Grada shkencore e fituar	Doktor e Shkencave Ekonomike
	Data / viti i diplomimit	2018
	Fusha e studimit	Financa

Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore

Grada shkencore	Doktor e Shkencave Ekonomike
Titulli akademik i fituar	Prof. Ass. Dr
Viti kur është fituar titulli aktual	2021
Vendimi Ref.nr. ____/____ Dt. ____/____/____	Nr . 01-537 / 08.03.2021
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	Universiteti "Kadri Zeka" Fakulteti Juridik
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	Ref . Nr 6/4- 4221

¹ Njohja e gradave universitare për të gjitha nivelet: Bachelor, Master dhe Doktoratë, të dokumentohet me vendime të MASHT të Kosovës

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2

Kandidatja Valbona Zeqiraj, sipas të dhënave noteriale dhe zyrtare, ka fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave Ekonomike” në vitin 2018 dhe mban titullin akademik “Prof. Ass. Dr.”, të fituar në vitin 2021, me Vendimin nr. 01-537, datë 08.03.2021, të Universitetit “Kadri Zeka”.

Kandidatja i ka të përfunduara të tri nivelet e studimeve në fushën e ekonomisë dhe financave, të cilat janë në përputhje të plotë me lëndët e shpallura në konkurs, duke dëshmuar një profil akademik dhe profesional të përshtatshëm për pozitën përkatëse.

Ajo ka një përgatitje të avancuar akademike dhe një përvojë të konsoliduar në arsimin e lartë, me mbi 13 vite angazhim akademik, si dhe mbi 5 vite përvojë në Universitetin “Kadri Zeka”, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në Statutin e UKZ-së, neni 171, lidhur me kriteret për zhvillimin dhe avancimin e personelit akademik.

Grada shkencore e doktoratës, thirrja akademike e fituar, përputhshmëria e kualifikimeve me fushën e konkursit, si dhe përvoja e gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dëshmojnë për profilin e konsoliduar profesional dhe akademik të kandidates. Njohja e kualifikimit përmes procedurave përkatëse të MASHT/NARIC (Ref. Nr. 6/4-4221) konfirmon vlefshmërinë e gradës shkencore dhe përputhshmërinë e saj me standardet e arsimit të lartë.

Tabela 3. Monografitë

Nr.	Autori/ët	Titulli i monografisë	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti ISBN
1	Valbona Zeqiraj	POLITIKAT TATIMORE DHE EFIKASITETI EKONOMIK NË KOSOVË	Financa	Flutura Kalemi Elvin Mekaj Petrir Hasanaj	Artini, Prishtinë 978-9951-28-579-7
2	Valbona Zeqiraj	POLITIKA MAKROFISKALE NË VENDET NË TRANZICION DHE NË KOSOVË	Financa	Flutura Kalemi Anila Bozdo	UFAGj, Gjakovë 978-9951-804-06-6

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj ka prezantuar dy monografi shkencore si auore e vetme, të fokusuara në fushën e financave, me trajtim të veçantë të politikave tatimore dhe makrofiskale në kontekstin e Kosovës dhe vendeve në tranzicion.

Monografitë “Politikat Tatimore dhe Efiikasiteti Ekonomik në Kosovë” dhe “Politika Makrofiskale në VenDET në Tranzicion dhe në Kosovë” trajtojnë tema me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik, menaxhimin e financave publike dhe hartimin e politikave ekonomike efektive.

Vlerësimi shkencor i këtyre veprave është mbështetur përmes recensioneve nga autorë të njohur dhe ekspertë të fushës së ekonomisë dhe financave, të cilët kanë konfirmuar rëndësinë, cilësinë metodologjike dhe kontributin akademik të monografive.

Këto botime përbëjnë një kontribut të vlefshëm për zhvillimin e shkencës ekonomike, pasurimin e literaturës universitare dhe mbështetjen e procesit akademik, duke u shërbyer studentëve, studiuesve dhe institucioneve në analizimin dhe kuptimin e politikave fiskale dhe ekonomike.

Tabela 4. Tekstet mësimore

Nr.	Autori/ët	Titulli i tekstit	Fakulteti/ Programi studimor	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti, ISBN
1	Artan Nimani Valbona Zeqiraj, Nexhmije Kabashi. Nevruz Zogu	Kapitali Intelektual	Burime njerzore, menaxhim, financa	Musa Limani Kudusi L:ame Sabaudin Komani	Kolegji Biznesi, Prishtinë 979-9951-561-14-3

Kandidatja Valbona Zeqiraj është bashkautore, së bashku me Artan Nimani, Nexhmije Kabashi dhe Nevruz Zogu. Ky tekst trajton tema të rëndësishme nga fushat e burimeve njerëzore, menaxhimit dhe financave, duke ofruar literaturë të dobishme për procesin mësimor universitar dhe për studentët e programeve ekonomike e menaxheriale.

Teksti mësimor është recensuar nga autorë të njohur të fushës akademike, përkatësisht Prof. Dr. Musa Limani, Prof. Dr. Kudusi Lame dhe Prof. Dr. Sabaudin Komani, të cilët kanë vlerësuar rëndësinë shkencore dhe vlerën akademike të këtij botimi që perdoret si teks mesimor nga Kolegji Biznesi, Prishtinë, dhe mbare ISBN 979-9951-561-14-3.

Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT nr. 01/2018 dhe nenit 5, pika 2.5 dhe nenit 10, pika 4 të Rregullores, 01/1328 dt. 26/06/2024, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues databazës
1	Valbona Zeqiraj Safete Haderxhonaj	HARMONIZING KOSOVO'S CIVIL LAW WITH EU STANDARDS: CHALLENGES AND STRATEGIES FOR INTEGRATION	JUS Vitaepensiero DOI: 0.26350/1827794 2_000202	Vëllimi 5- 134-161 2024	https://jus.vitaepensiero.it/news/papers/harmonizing-kosovos-civil-law-with-eu-standards-challenges-and-strategies-for-integration-6705.html
2	Gazmore Rexhepo Valbona Zeqiraj* *autor korespondent	THE THRESHOLD EFFECT OF PUBLIC DEBT ON ECONOMIC GROWTH: THE CASE OF THE NEW EUROPEAN UNION MEMBER STATES	Journal of Governance and Regulation https://doi.org/10.22495/jgrv12i2art18	Vëllimi 12(2), pp. 194–199 2023,	https://virtusinterpret.org/IMG/pdf/jgrv12i2art18.pdf

3	Valbona Zeqiraj Artan Nimani	<i>IMPACT OF THE QUALITY OF HOSPITALITY SERVICES ON CUSTOMER SATISFACTION – KOSOVO CASE STUDY</i>	Quality - Access to Success doi. 10.47750/QAS/23186.14	Volum 23(186), pp. 104–110 2022,	https://www.proquest.com/scholarly-journals/impact-quality-hospitality-services-on-customer/docview/2818311394/se-2
4	Artan Nimani Valbona Zeqiraj *autor korrespondent Denis Spahija	The importance of corporate social responsibility for companies: The developing market study	Journal of Governance and Regulation / doi. 10.22495/jgrv11i4siart11	Volume 11, Issue 4, Special Issue, 2022	https://virtusinterpress.org/IMG/pdf/jgrv11i4siart11.pdf
5	Sherif Sejdiu Valbona Zeqiraj *autor korrespondent Artan Nimani	<i>Economic efficiency and finance in the development of the forest economy within the framework of legal restrictions</i>	Ukrainian Journal of Forest and Wood Science, doi.org/10.31548/forest/2.2024.79	Volume 15(2), pp. 79–96 2024,	https://forestscience.com.ua/en/journals/tom-15-2-2024/yekonomic-hna-yefyektivnist-i-finansi-v-rozvitku-lisovogo-gospodarstva-v-ramkakh-pravovikh-obmyezhyen
6	Artan Nimani Valbona Zeqiraj	Statistical Analysis of the Effects of the Global Financial Crisis in Kosovo	Acta Universitatis Danubius. Economica	Vol. 17, No. 4, p.121, 2021	https://dj.univ-danubius.ro/index.php/AUDOE/article/view/1188/1421

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj ka realizuar një veprimtari shkencore të konsoliduar dhe me ndikim ndërkombëtar, duke paraqitur gjashtë (6) punime shkencore të botuara në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus dhe Web of Science, në përputhje me kërkesat e UA-MASHT nr. 01/2018, si dhe me nenin 5, pika 2.5 dhe nenin 10, pika 4 të Rregullores nr. 01/1328, datë 26.06.2024.

Komisioni vlerëson se veprimtaria shkencore e kandidatës karakterizohet jo vetëm nga numri i publikimeve, por edhe nga cilësia, relevanca dhe ndikimi i tyre në komunitetin akademik ndërkombëtar. Punimet janë botuar në revista që aplikojnë proces rigoroz të vlerësimit shkencor (peer review) dhe trajtojnë tema bashkëkohore nga fushat e financave publike, politikave fiskale dhe makrofiskale, institucioneve financiare ndërkombëtare, analizës statistikore, përgjegjësisë sociale të korporatave, zhvillimit ekonomik, harmonizimit të legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian, zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes moderne, duke reflektuar përputhshmëri të plotë me profilin akademik të kandidatës dhe me fushën e konkursit.

Komisioni thekson si element me rëndësi të veçantë faktin se në të gjitha publikimet kandidatja paraqitet si autore e parë ose autore korresponduese, çka dëshmon se ajo ka pasur rolin udhëheqës në konceptimin, hartimin, realizimin dhe publikimin e kërkimeve shkencore. Ky rol përfaqëson një tregues të qartë të pavarësisë akademike, kapacitetit kërkimor dhe kontributit të saj origjinal në zhvillimin e dijes shkencore, duke tejkaluar rolin formal të bashkautorësisë.

Komisioni ka verifikuar secilin publikim përmes lidhjeve elektronike (DOI dhe databazave identifikuese) të paraqitura në dokumentacion dhe ka konstatuar se të gjitha punimet janë të indeksuara në databazat e kërkua nga legjislacioni në fuqi. Si rrjedhojë, ato përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë së publikimeve shkencore dhe janë të vlefshme për procedurën e avancimit akademik.

Bazuar në vlerësimin cilësor dhe sasior të veprimtarisë shkencore, Komisioni konstaton se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani jo vetëm që i përmbush, por edhe i tejkalon standardet e përcaktuara me nenin 171 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka", si dhe me UA-MASHT nr. 01/2018 dhe Rregulloren nr. 01/1328, datë 26.06.2024, duke dëshmuar një produktivitet të lartë shkencor, lidhshmëri në kërkimin akademik dhe afirmim të qëndrueshëm ndërkombëtar. Këto arritje përbëjnë bazë të fortë akademike për avancimin e saj në thirrjen Profesor i Asociuar (Prof. Asoc. Dr.).

Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, BeH)

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1	Artan Nimani Valbona Zeqiraj	Opportunities for Economic Development Based on Tourism Potentials in Kosovo	Knowledge International Journal	Vol. 30, No.1, p.263, 2019	https://www.researchgate.net/publication/335625261 OPPORTUNITIES FOR ECONOMIC DEVELOPMENT BASED ON TOURISM POTENTIALS IN KOSOVO
2	Valbona Zeqiraj	The Role and Importance of Time and Stress Management in Business	Macedonian Journal Repository	Vol. 53, No.1, p.35, 2022	https://izvor.net.mk/article.php?id=372555
3	Valbona Zeqiraj	Taxes and their Effects on Business Environment	Academic Journal of Interdisciplinary Studies DOI: 10.5901/mjss.2015.v4n1p91; ISSN 2281-3993	Vol. 4, No. 1, pp. 91–96, 2015	
4	Artan Nimani Valbona Zeqiraj	Trade Exchanges Between Kosovo and Albania and the Perspective of Economic Integration in the Western Balkans.	Mediterranean Journal of Social Sciences and Humanities	Vol. 5, No. 1, fq. 53–66. 2024,	https://www.umsh.edu.al/media/67cac902efe2c.pdf?utm_source=chatgpt.com

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6

Kandidatja Valbona Zeqiraj Nimani ka paraqitur 4 punime publikuara në revistat jashtë territorit të Republikës së Kosovës, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Nga dokumentacioni i verifikuar përmes dosjs dhe linkut rezultojnë se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj i ka publikuar katër (4) punime shkencore në revista rajonale me karakter ndërkombëtar, të botuara në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut. Punimet trajtojnë tema me rëndësi në fushën e ekonomisë, financave, politikave tatimore, menaxhimit, zhvillimit ekonomik, turizmit dhe integritetit ekonomik rajonal, duke dëshmuar vazhdimësi në veprimtarinë kërkimore dhe kontribut në zhvillimin e mendimit shkencor në këto fusha.

Komisioni vlerëson se publikimet në revista rajonale pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të kandidatës në kërkimin shkencor, promovimin e rezultateve të saj në komunitetin akademik rajonal dhe zgjerimin e bashkëpunimit shkencor përtej institucioneve vendore. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Komisioni konstaton se kandidatja i përmbush kriteret e përcaktuara të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ (Ref. nr. 01/1328, datë 26.06.2024), lidhur me publikimin e punimeve shkencore në revista rajonale.

Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1	Valbona Zeqiraj	Characteristics of SME in Kosovo	Biznesi – Revista Shkencore e Fakultetit Ekonomik	Nr. 11, fq. 18–24, 2012	https://kolegijibiznesi.com/Studentet_aktual/38

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7

Kandidatja Valbona Zeqiraj Nimani ka paraqitur 1 punim publikuara në revistat të botuara në Republikën e Kosovës, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Tabela 8. Prezantimet në konferenca

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1	Valbona Zeqiraj	Bitcoin, mundësi apo rrezik,	INSTITUTI PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM ULQIN,	06 Prill/April, 2018 Mali I Zi.	https://eprints.uklo.edu.mk/id/eprint/7649/1/Ekonomik_10_1.pdf?utm_source=chatgpt.com
2	Valbona Zeqiraj	Main characteristics of SME in Kosovo]	Alb Shkenca	Shkup, 29 - 31 Gusht 2012;	Microsoft Word - Programi Ekonomia M.K A. H
3	Valbona Zeqiraj et	Global Crisis Financial Policies	4th International Conference on Social Sciences (ICSS), Bukuresht, Rumani	Vol. I, 2015	4th_ICSS2015_ProceedingsBook_Vol_1 (EUSER)
4	Valbona Zeqiraj	The Role of Business Dictionaries	CSS IX - 9th International Conference on Social Sciences, Dubrovnik, Kroaci	Proceedings, 2016	https://www.researchgate.net/publication/303518663_Proceedings_of_the_9th_International_Conference_on_Social_Sci

					ences
5	Valbona Zeqiraj	Price Movement Impact in Applying VAT in Kosovo	International Scientific Conference, Bosnje dhe Hercegovinë	Conference Proceedings Book, Year 3, No. 3, ISSN 2232-8742, 2013	https://bosniaca.nub.ba/index.php/bosniaca
6	Valbona Zeqiraj (bashkautore)	Scientific and Technological Development – Factor of Modern Wars and Wars of the Future	XXXVII International Scientific Conference, Strugë, Maqedonia e Veriut	Programi i Konferencës, 2022	https://iust.edu.mk/en/research-and-publications/conference/
7	Valbona Zeqiraj (bashkautore)	Managing Public Finances in Kosovo	Konferenca Vjetore Shkencore e Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan	UKZ Conference 2024	https://conference2024.uni-gjilan.net/
8	Valbona Zeqiraj	Fiscal Policies in the Digital Age: Taxation of the Digital Economy with Focus on Kosovo	Konferenca Vjetore Shkencore e Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan	UKZ Conference 2025	https://conference2025.uni-gjilan.net/
9	Valbona Zeqiraj (bashkautore)	Digital Transformation as a Pillar of Reform in Public Financial Management	Konferenca Vjetore Shkencore e Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan	UKZ Conference 2025	https://conference2025.uni-gjilan.net/
10	Valbona Zeqiraj (bashkautore)	Trade Exchanges Between Kosovo and Albania and the Perspective of Economic Integration in the Western Balkans	International Scientific Conference, Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë	Mediterranean Journal of Social Sciences and Humanities, Vol. 5, No.1, fq. 53–66, 2024, ISSN 2980-178	https://www.umsh.edu.al/media/67cac902efe2c.pdf

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Valbona Zeqiraj Nimani në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e saj në 10 konferenca të ndryshme shkencore nga fusha e edukimit. Me këtë kandidat i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.1 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur rezulton se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani ka marrë pjesë aktive në 10 konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga universitete dhe institucione të njohura shkencore në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Rumani. Punimet e prezantuara trajtojnë tema aktuale nga fushat e financave publike, politikave fiskale, ekonomisë, biznesit ndërkombëtar, transformimit digjital, menaxhimit të financave publike, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, integritetit ekonomik dhe e-qeverisjes, duke dëshmuar vazhdimësi në veprimtarinë kërkimore dhe angazhim të qëndrueshëm në komunitetin shkencor ndërkombëtar.

Komisioni vlerëson se pjesëmarrja e vazhdueshme në konferenca shkencore ka kontribuar në promovimin e rezultateve të kërkimeve të kandidatës, në shkëmbimin e përvojave akademike dhe në forcimin e

bashkëpunimit me komunitetin shkencor vendor dhe ndërkombëtar. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni konstaton se kandidatja i përmbush kriteret e përcaktuara të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ (Ref. nr. 01/1328, datë 26.06.2024), lidhur me pjesëmarrjen aktive në konferenca shkencore.

Tabela 9. Kontribute të tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, Viti
1	Valbona Zeqiraj	Redaktore në librin “Feja e parasë- kodi i besimit global”	Prishtinë 2026

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

Kandidati Valbona Zeqiraj në dosjen e dorëzuar ka paraqitur i ka paraqitur edhe 1 kontribute të tjera, si redaktore në librin Feja e Parisë, botuar nga OLYMP Prishtinë, përkatësisht me fushën e saj të ekspertizes.

Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Titulli akademik	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2012-2015	Ligjeruese	Kolegji Biznesi	Menaxhmet dhe Financa	Financa, E drejta Financiare, Biznesi Ndekombetar, MBNJ	
2015-2020	Prof. Ass	Kolegji Biznesi	Menaxhmet dhe ekomomiks Juridik Menaxhim dhe financa	Financa, etika ne biznes, Biznesi Ndekombetar, BVM	
2021-aktual	Prof.Ass.Dr	UKZ	Juridik, qeverisje	E-E drejta financiare, Institucionet financiare nderkombëtare, Menaxhimi dhe e-qeverisja, praktika profesionale, Politika ekonomike, e drejta e tregut publik, e drejta tatimore dhe buxhetore	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidatja Valbona Zeqiraj Nimani ka filluar punën akademike në vitin 2012 dhe deri tani ka një përvojë të

gjatë në mësimdhënie brenda dhe jashtë UKZ. Ka mbi katër vite në thirrjen Profesor Asistent në UKZ nga 2021. Për shumicën e lendeve që janë në konkurs. Po ashtu kandidatja ka sjellë dëshmi të përvojës së saj disaveçare në arsimin e lartë. Prandaj, kandidatja i plotëson kushtet sipas nenit 171, paragrafi 1, pikat 1.4 dhe 1.5, të Statutit të UKZ-së, si dhe nenit 7, paragrafi 1, pikat 1.5 dhe 1.6, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024, Komisioni vlerëson se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani ka ndërtuar një përvojë të qëndrueshme dhe progresive në mësimdhënie universitare, me mbi 13 vite angazhim në institucionet e arsimit të lartë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka ligjruar lëndë nga fushat e financave, të drejtës financiare, biznesit ndërkombëtar, menaxhimit, politikave ekonomike, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe e-qeverisjes, duke dëshmuar kompetencë profesionale dhe përputhshmëri të plotë me fushën e konkursit.

Komisioni vlerëson se kandidatja ka avancuar në mënyrë të vazhdueshme në karrierën akademike, duke kaluar nga pozita e ligjrueses në atë të Profesorit Asistent me gradën Doktor i Shkencave, ndërsa aktiviteti i saj pedagogjik është shoqëruar me mentorim të punimeve master, organizim të praktikës profesionale dhe angazhim në zhvillimin e programeve studimore. Po ashtu, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kandidatja ka ndjekur programe të ndryshme të zhvillimit profesional dhe është pajisur me certifikata për ngritjen e kompetencave akademike dhe pedagogjike, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Vlerësimet pozitive të punës së saj akademike dhe angazhimi i vazhdueshëm në procesin mësimor dëshmojnë përkushtim, profesionalizëm dhe përmbushje të standardeve të kërkuara për avancim në thirrjen Profesor i Asociuar.

Tabela 11. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës

<i>Periudha e mentorimit</i>	<i>Institucioni, Vendi</i>	<i>Titulli i temës</i>	<i>Master doktoratë</i> /	<i>Vërejtje</i>
2024	UKZ, Gjilan	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore përmes vlersimit të performancës në sektorin publik	Master. Juridik	Kandidati Mevlud Haxhiu
2004-25	UKZ, Gjilan	Nderlidhja në mes të menaxhimit të BNJ me trajnimet dhe vlersimin e performances se personelit në Komunen e Gjilanit	Maste, E-qeverisja	Kandidatja: Tuba Klaiqi
2025	UKZ, Gjilan	Etika e përdorimit të teknologjisë dhe efekti në mesimnxenje	Master, E-qeverisja	Kandidatja: Kosovare Basha
2026	UKZ, Gjilan	E-qeverisaj dhe menaxhimi i të dhënave demografike në Komunen e Vitisë	Master, E-qeverisja	Kandidatja: Enduena Salihu
2006, në proces	UKZ, Gjilan	Ndikimi i digjitsizimit në performancën e ndërmarrjeve publike	Master, E-qeverisja	Kandidati: Burhan Isusi

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11

Kandidatja Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani ka realizuar me sukses procesin e mentorimit të pesë (5) punimeve të nivelit Master në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, ndërsa ka paraqitur edhe tema të tjera të cilat aktualisht janë në proces të mentorimit.

Temat e udhëhequra nga kandidatja janë të orientuara në fusha me rëndësi bashkëkohore akademike dhe institucionale, si menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i performancës, trajnimi i personelit, e-qeverisja, digjitalizimi dhe menaxhimi i të dhënave publike, duke reflektuar përvojën dhe ekspertizën e saj profesionale e shkencore.

Angazhimi i vazhdueshëm në mentorimin e studentëve të nivelit Master dëshmon për kontributin e kandidates në zhvillimin e procesit mësimor, orientimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kuadrove të reja akademike e profesionale.

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, kandidatja i përmbush kërkesat e përcaktuara me Statutin e Universitetit “Kadri Zeka” dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, datë 26.06.2024.

Ky angazhim përbën një dëshmi të rëndësishme të veprimtarisë së saj akademike dhe të kontributit në realizimin e misionit arsimor dhe shkencor të Universitetit.

Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Kandidatja Valbona Zeqiraj Nimani Në dosjen e saj ka dëshmuar që ka marrë pjese në shume trajnime dhe aktivitete tjera shkencore brenda dhe jashtë UKZ-së.

I. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI ***Profesor asociuar (Prof. Asoc. Dr.)***

Komisioni vlerësues, i formuar me vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan (Nr. prot. 547/26, dt. 28.07.2026), duke u bazuar në nenin 171 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjiilan, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit “Kadri Zeka” Gjiilan, Ref. nr. prot. 01/1446, datë 21.07.2026, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatës, si dhe vlerësimit që kandidatja dëshmon mbi mesimdhënjen dhe vlersimin brenda UKZ-së për pozitën një mesimdhënës/e për lëndët: Institucionet Financiare Ndërkombëtare; E Drejta Biznesore Ndërkombëtare; Globalizimi dhe Tregtia Ndërkombëtare; Menaxhimi dhe E-Qeverisja; Statistika për E-Qeverisje.

PROPOZON

Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani **të avancohet** në thirrjen akademike **Profesor e asociar (Prof. Asoc.Dr.)** në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.

ARSYETIM

Komisioni vlerësues, pasi shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e paraqitur nga kandidatja Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani, analizoi përmbushjen e kriterëve ligjore, statutare dhe akademike, si dhe vlerësoi në tërësi veprimtarinë e saj mësimore, shkencore dhe profesionale. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni arriti në përfundimin se kandidatja i plotëson plotësisht, madje në disa elemente edhe i tejkalon, kriteret e përcaktuara për avancim në thirrjen **Profesor i Asociuar (Prof. Asoc. Dr.)**.

Ky vlerësim mbështetet në dispozitat e nenit 171 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, nenit 7 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ (Ref. nr. 01/1328, datë 26.06.2024), si dhe në kriteret e përcaktuara në konkursin publik për zgjedhjen/riemërimin e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Ref. nr. 01/1446, datë 21.07.2026.

Komisioni vlerëson se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani ka ndërtuar një profil të qëndrueshëm dhe të konsoliduar akademik në fushën e ekonomisë, financave, politikave fiskale dhe makrofiskale, institucioneve financiare ndërkombëtare, së drejtës financiare dhe tatimore, tregtisë dhe biznesit ndërkombëtar, menaxhimit publik, e-qeverisjes, statistikës së aplikuar dhe administrimit publik. Këto fusha përputhen drejtpërdrejt me lëndët e shpallura në konkurs, duke dëshmuar kompetencë të plotë profesionale për realizimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Veprimtaria shkencore e kandidatës dëshmon nivel të lartë produktiviteti dhe ndikimi akademik. Ajo është autore e dy monografive shkencore në fushën e financave dhe politikave fiskale, përkatësisht "Politikat Tatimore dhe Efikasiteti Ekonomik në Kosovë" dhe "Politika Makrofiskale në Vendet në Tranzicion dhe në Kosovë", si dhe bashkautore e tekstit universitar "Kapitali Intelektual", të cilat përfaqësojnë kontribut të rëndësishëm në pasurimin e literaturës universitare dhe zhvillimin e mendimit shkencor në këto fusha.

Njëkohësisht, kandidatja ka dëshmuar vazhdimësi në kërkimin shkencor përmes publikimit të punimeve në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databaza të njohura si Scopus, Web of Science dhe databaza të tjera ndërkombëtare. Punimet e saj trajtojnë tema me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik, financat publike, harmonizimin e legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian, borxhin publik, përgjegjësinë sociale të korporatave, zhvillimin e qëndrueshëm, tregtinë ndërkombëtare, statistikën ekonomike dhe qeverisjen moderne. Për më tepër, ajo ka prezantuar rezultatet e kërkimeve të saj në konferenca të shumta shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në afirmimin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" në komunitetin akademik vendor dhe ndërkombëtar.

Përvoja shumëvjeçare në mësimdhënie universitare, angazhimi në programe studimore, mentorimi i punimeve master, pjesëmarrja në aktivitete akademike dhe kontributi në zhvillimin institucional dëshmojnë përgatitje të lartë pedagogjike, profesionale dhe organizative. Kandidatja ka treguar vazhdimësi në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe në promovimin e standardeve akademike të Universitetit.

Duke u bazuar në vlerësimin gjithëpërfshirës të dokumentacionit, në arritjet shkencore, në veprimtarinë akademike dhe profesionale, si dhe në përmbushjen e plotë të kriterëve të përcaktuara me aktet normative të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Komisioni vlerësues vlerëson se Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani përfaqëson një profil akademik me integritet të lartë profesional, me kompetenca të dëshmuara në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe me potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit Ekonomik dhe të Universitetit. Për këto arsye, Komisioni i propozon me bindje të plotë Senatit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan zgjedhjen/ avancimin e Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj Nimani në thirrjen akademike **Profesor i Asociuar (Prof. Asoc. Dr.)**, duke vlerësuar se ajo plotëson në tërësi standardet ligjore, akademike dhe profesionale të kërkuara për këtë pozitë.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Prof. Asoc. Dr. Fadil Osmani, kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Demir Limaj, anëtar
3. Prof. Dr/ Vehbi Ramaj, anëtar

Gjiilan, më 11 Gusht 2026

